

URDHËR
Nr. 925, datë 29.10.2021

**PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË DEKLARIMIT TË PASURISË DHE
INTERESAVE PRIVATË**
(Në sistemin elektronik të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS)

Në zbatim të nenit 4/2, nenit 21 dhe nenit 42/2, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshua, dhe me ligjin nr. 105/2018, datë 13.12.2018,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularit të deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë “Deklaratë periodike vjetore për subjekte në funksion”, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Evgjeni Bashari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.ildkpkj.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATË PERIODIKE VJETORE
NË FORMAT ELEKTRONIK PËR SUBJEKTE NË FUNKSION

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	
---------------------------------------	--

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që mbart detyrimin për deklarim të interesave privatë të tij, të bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014, me Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017 dhe Ligjin nr. 105/2018, datë 13.12.2018.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË

Emri	Atësia	Mbiemri
Funksioni		
Institucioni dhe adresa		
Data e emërimit në funksionin që kryen	Data e dorëzimit të deklaratës	

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës -Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, që të verifikojnë në të gjitha subjektet privatë e publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Jap pëlqimin për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

--



**TË DHËNA PERSONALE
TË SUBJEKTIT DHE
PERSONAVE TË LIDHUR**

PËRBËRJA FAMILJARE E SUBJEKTIT SIPAS CERTIFIKATËS SË GJENDJES CIVILE

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
					DEKLARUESI	

Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në Gjendjen Civile:
(Njësia Administrative Nr. , Rruga, Pallati nr., Bashki/Komunë)

Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni:	
---	--


Rrethi i personave të lidhur me subjektin, në funksion të kufizimit të interesave privatë për konfliktin rast pas rasti dhe të vazhdueshëm janë: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore (brenda ose jashtë trungut familjar) dhe prindërit e subjektit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetusit/es.

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
					Babai i deklaruesit	
					Nëna e deklaruesit	
					Babai i bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	
					Nëna e bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	
					I biri/e bija e ndarë nga prindërit	
					Bashkëjetuesi/ Bashkëjetuesja	

Të dhënat në këtë faqe janë konfidenciale.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

--



**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite sipas gjërme a, b, c, ç, d të nenit 4, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale sipas Kodit Civil, tuaja dhe/ose në bashkëpronësi me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë, gjendje më dt. 31.12.2021, në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloji pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera	Pjesa në %

* Objekti i deklaramit (Neni 4, gjërma a, b, c, ç, d i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash, jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues



**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET
NË VEPRIMTARI
PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021.

Përshkruani hollësisht të ardhurat, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura për subjektin, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri më 31 dhjetor 2021, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues



**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021, si dhe detyrimet e lindura për subjektin, gjatë vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklaruës ka detyrime financiare, janë fusha konfidenciale.

Përkthimi i hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor 2021 (Principal + interes)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 dhjetor 2021. (Principal)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklaruës



SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Përshkruani hollësisht çdo lloj shpenzimi të deklarueshëm me vlerë mbi 300.000 lekë, si për arsim, mjekim, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji, të kryera nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Të dhënat për shpenzimet e deklarueshme janë fusha konfidenciale.

Përshkrimi i shpenzimeve	Shuma në lekë ose valutë të huaj


Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues



DHURATA DHE TRAJTIME PREFERENCIALE

Përshkruani hollësisht llojin e dhuratës në vlerën mbi 10 000 (dhjetë mijë lekë), si dhe trajtime preferenciale, <u>nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri më 31 dhjetor 2021</u> , në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik. Të dhënat për dhuratat dhe trajtimet preferenciale janë fusha konfidenciale.	Identiteti i personit fizik ose juridik dhe lidhja e tij me zyrtarin.	Vlera e dhuratës /trajtimit preferencial në lekë ose valutë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues



**PERSONAT FIZIKË/JURIDIKË DHE
PERSONAT E BESUAR**

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me zyrtarin që mbart detyrimin për deklarim, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për personat e besuar janë fusha konfidenciale.

Emër, Atësi, Mbiemër i personit fizik dhe /ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me deklaruuesin	Lloji i interesave private, vendndodhja e tyre.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.ildkpkj.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi
në ILDKPKI

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATË
E PERSONIT TË LIDHUR

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur me subjektin deklarues (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

Autorizoj:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, që të verifikojnë në të gjitha subjektet privatë e publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/ja _____,

Emër, Atësi, Mbiemër

bashkëshorti/ja ☐

fëmijë madhorë së bashku me prindërit ☐

fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit ☐

bashkëjetuesi/ja ☐

i/e Subjektit _____.

Emër, Atësi, Mbiemër

Jap pëlqimin për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim/Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur



**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite, sipas gërmës a, b, c, ç, d të nenit 4, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale sipas Kodit Civil, tuaja dhe/ose në bashkëpronësi me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë, gjendje më 31.12.2021 në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera	Pjesa në %

*Objekti i deklaramit (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur




**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË
VEPRIMTARI PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021.

Përshkruani hollësisht të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri më 31 dhjetor 2021, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur



**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**


Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.), që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021, si dhe detyrimet e lindura për subjektin gjatë vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve personi i lidhur ka detyrime financiare, janë fusha konfidenciale.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor 2021 (Principal + interes)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit (Principal)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur




SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Përshkruani hollësisht çdo lloj shpenzimi të deklarueshëm me vlerë mbi 300.000 lekë, si për arsim, mjekim, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji, të kryera nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Të dhënat për shpenzimet e deklarueshme janë fusha konfidenciale.

Përshkrimi i shpenzimeve	Shuma në lekë ose valutë të huaj

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur



**PERSONAT FIZIKË/JURIDIKË DHE
PERSONAT E BESUAR**

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me personin e lidhur që mbart detyrimin për deklarim, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Të dhënat për personat e besuar janë fusha konfidenciale.

Emër, Atësi, Mbiemër i personit fizik dhe /ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me deklaruesin	Lloji i interesave privatë, vendndodhja e tyre.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur



Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave privatë, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

- Ligj nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar
- Ligj nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Deklarimi i interesave privatë, periodike vjetore në formë elektronike, për subjekte në funksion, gjendje më dt. 31.12.2021, duhet të plotësohet në sistemin elektronik online EACIDS nga zyrtari (subjekt deklarues) në funksion apo në detyrë më dt. 31.12.2021 dhe personat e lidhur me të.

- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesi/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit, gjendje më dt. 31.12.2021.
(Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin periodik vjetor të interesave privatë dhe konfliktit të interesave për vitin 2021, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave privatë periodike vjetore në formë elektronike për subjektet në funksion, për pasuritë e akumuluar ndër vite dhe detyrimet financiare, që janë **gjendje në dt. 31.12.2021**, si dhe burimin e krijimit të tyre).
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo person i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore), me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Deklarata e interesave privatë, periodike vjetore, në formë elektronike për subjektet në funksion, duhet plotësuar dhe dorëzuar brenda datës 31 mars 2022, si vijon:
 - **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
 - **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.

Deklarimi i interesave privatë, periodike vjetore, në formë elektronike, për subjekte në funksion, gjendje më dt. 31.12.2021, duhet të plotësohet nga personat e lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, për pasuritë që disponojnë veçmas, dhe plotësojnë formularin përkatës, si vijon;

- **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
- **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse.

▪ Subjekti/zyrtari nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave privatë të personave të lidhur.

Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
 - Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
 - Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
 - Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
 - Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.
- Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklaratës duhet të nënshkruhen, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.**
- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit **042 259 461** Free.08009999, info@hidaa.gov.al.
 - Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.

Shënim: Ky formular i deklarimit plotësohet vetëm një herë, për pasuritë e akumuluar ndër vite dhe dorëzohet në autoritetin përgjegjës të institucionit publik, brenda datës 31 mars 2022.